



Nr. i protokollit:1777

Me datë: 01.06.2017

Rahovec

Në bazë të nenit 17, 24 dhe nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); nenit 2 dhe nenit 4 të Ligjit për Financat e pushtetit lokal me Nr.03/L-049 të dt. 13.05.2008, nenit 63 ,65 , 85 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Drejtoria për Buxhet dhe Financa e harton këtë :

## **Plan për realizimin e të hyrave komunale në raport me planifikimin**

Ky plan ka për qëllim të mobilizoj të gjitha resurset që janë kompetentet për të vepruar me të gjitha kapacitetet, në mënyrë që të kemi një realizim sa më efikas edhe rezultate më të mira në realizimin e të hyrave të përgjithshme komunale. Më poshtë mund ti shihni veprimet dhe hapat e nevojshëm për inkasimin e të hyrave të planifikuara komunale:

1. Respektimi i ligjeve, statutit, rregulloreve, dhe urdhëresave aktuale të cilat janë në fuqi.
2. Angazhim maksimal i të gjithë zyrtareve kompetent të cilët janë përgjegjës për inkasim të hyrave, e në veçanti nga eproret e tyre ( Drejtoret, Menaxherët e sektorëve).
3. Koordinim i mire në këtë proces në mes të drejtorive, me theks të veçantë koordinim i mirë në mes të Drejtorisë së Inspektionit me Drejtorin e Urbanizmi, Shërbimeve Publike, Ekonomisë , Bujqësisë etj.
4. Sensibilizimi (njoftimi) publik i të gjithë qytetareve, dhe kreditoreve të komunës përmes mediave (televizion, radio, mediave elektronike, shpalljeve etj).
5. Njoftimi paraprak dhe me kohe i qytetareve (kreditoreve) për obligimin e krijuar përmes ,aktvendime, vërejtjeve me shkrim, vizitave, thirrjeve etj.
6. Planifikimi i auditimit të brendshëm ekskluzivisht vetëm për inkasimin e të hyrave në kuadër të çdo drejtorie, me auditime ad-hoke, të cilat duhet të jenë minimum dy auditime brenda vitit në kuadër të çdo drejtorie.

7. Krijimi i dy Task-forcave, me përbërje staf civil dhe epror, të cilat veprojnë ndaras njëra nga tjetra. Task forca e parë merr përgjegjësinë e inkasimit të të hyrave nga tatimi në pronë dhe taksën në biznese, ndërsa task-forca e dytë merr përgjegjësinë e inkasimit të të hyrave nga Shfrytëzimin pronës publike, dhe objekteve me qira (kontrata).
8. Zgjerimi i bazës së të hyrave, ideja e krijimit të taksave të reja në Drejtori të caktuar.

Rahovec,

17.05.2018

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Afrim Limani

